

## KUNDERSHTIM

Nga: Prof. dr. Dervish Alimi,  
Kandidat për Rektor në zgjedhjet rrjedhëse

Si palë e interesuar dhe për hir të mbarëvajtjes së procedurës zgjedhore dhe të ruajtjes së prestigjit dhe autoritetit të Institucionit tonë, e kundërshtoj pranimin e aplikimit për rektor të kandidates Prof. dr. Myqereme Rusi, sepse mendoj se nuk i keni pasur parasysh kriteret ligjore, gjegjësisht duhet ta keni pasur parasysh moshën e daljes së saj në pension, në prag të përfundimit të zgjedhjeve. Këtë e mbështës edhe me argumente juridike ligjore, bazuar në Nenin 147 të Ligjit për Arsim të Lartë, ku thuhet se:

Personit të përzgjedhur në pozicionin mësimor-shkencor ose mësimdhënës, i cili ka vazhduar kontratën e punës gjatë vitit shkollor në përputhje me rregulloren e marrëdhënieve të punës, marrëdhënia e punës i zgjat deri në fund të vitit shkollor, (pra në shtator 2023, në kohë të pushimeve verore!). Ky nen nga ligji për arsim të lartë, është rregulluar më detalisht në Statutin e UT: **Neni 113 i Statutit, Mënyra e përzgjedhjes dhe shkarkimi i rektorit, ku thuhet se:**

**Mandati i rektorit përfundon para përfundimit të periudhës për të cilën ai është zgjedhur, në një nga rastet e mëposhtme, ndër të tjera nëse plotëson kushtet për pension pleqërie.** Në kuadër të interpretimit logjik i bie se edhe sikur të jetë zgjedhur në korrik, asaj duhet t'i përfundojë mandati pas 2 muajsh, pra para përfundimit të periudhës për të cilën është zgjedhur, që d.m.th. se nuk mund të zgjidhet dikush që së shpejti do të del në pension, dhe kjo çështje rregullohet shumë qartë me këtë nen, edhe në kuadër të interpretimit logjik të ligjit!

Duke i interpretuar këto nene, e kundërshtoj pranimin e kandidaturës së saj, edhe për faktin se kam frikë se në rast të fitores së saj, universiteti do të ballafaqohet me situatë të sikletshme dhe do të bëhet objekt i sulmeve dhe talljeve të opinjonit publik, se gjoja Ne si tempull i dijes nuk kemi 'ditur' të interpretojmë nenet e Statutit që vetë e kemi votuar, dhe kjo nuk do të mund të arsyetohet, aq më tepër kur dikush paraprakisht këtë uq ka bërë të ditur!

Pra, në rast të fitores së saj, do të duhet t'i dorëzohet mandati një kandidateje të cilës i pushon marrëdhënia e punës bazuar në nenin 113 të Statutit të UT! Në situatën kur statuti e parashikon tashmë një rast të tillë, ne si institucion jemi të obliguar ta respektojmë dhe zbatojmë të njëjtin pa asnjë hezitim dhe përjashtim.

Si dëshmi për pretendimet e mia, jua citoj nenet përkatëse të ligjit dhe statutit në fuqi, edhe në gjuhën maqedonase, ashtu siç janë të shpallur në internet.

**Престанок на работен однос поради исполнување на услови за пензија**

**Член 147**

На лицето избрано во наставно-научно или наставно звање, кое во текот на учебната година го продолжило договорот за вработување согласно прописите за работните односи, работниот однос му трае до крајот на учебната година. Начинот на изборот и разрешување на rektorot поблиску се уредува со статутот на универзитетот.

**Член 113 на Статутот на УТ**

Мандатот на ректорот престанува пред истекот на периодот на периодот на кој е избран, во еден од следните случаи:

**- ако ги исполнува условите за старосна пензија**

Uroj që ta rishikoni vendimin tuaj me seriozitetin më të madh dhe të merrni vendim në baze të ligjit, dhe jo në bazë të hamendësimeve dhe me lojëra fjalësh, sepse fundja përgjegjësia për shkeljet ligjore është personale dhe jo kolektive.

Me dt. 13.06.2023

Me përshëndetje miqësore!

Nga parashtruesi i kundërshtimit:

  
Prof. dr. Dervish Alimi